

*Nanës Arife dhe
fëmijëve të mi për frymëzim e
bashkëpunim si dhe xhji. Lirie
për ribotimin e kësaj vepre.*

Autori



Nuhi Veselaj

S q a r i m :

Përmbledhja "Rrezet e ylberta" është botuar për të parën herë nga NGB "Rilindja", redaksia "nxënësi", nën redaktimin e z. Mehmet Gjevori, Prishtinë 1971.

Atëherë që pritur mirë dhe si e tillë ka qenë paraparë si literaturë shkollore për klasën IV, mirëpo pasi që autori ndiqej si i papërshtatshëm nga regjimi i atëhershëm, kjo vepër u hesht si literaturë, madje edhe për ribotimin e saj as që mund të bëhej fjalë.

Tashti po jepet e ribotuar pa ndonjë ndryshim të vërejtshëm gjuhësor a ideor, prandaj lexuesi ka mundësi ta vlerësojë edhe nga pozita e sotme, qoftë pikëpamjen ideoestetike gjuhësore, ashtu edhe atë përmbajtësore edukative të veprës në fjalë.

Sidoqoftë, sidomos lexuesve të rinj, u dëshiroj disponim të këndshëm gjatë leximit a rileximit të vjershave të caktuara nga kjo përmbledhje!

Prishtinë, qershor 1996

Autori

RREZET E YLBERTA

-Pse rendni, ku shkoni,
o fëmijë të mirë?
-Do ta zëmë ylberin,
po kemi dëshirë.

-Ylberi nuk zihet,
s'mund të kapet dot!
-Xhaxhi, thanë fëmijët,
do ta zëmë ne, sot...

Rendnin fluturonin
plaku i vështronte,
në faqe të qiellit
duket se lexonte:

Kur RREZE LIRIE
derdhen në shumë ngjyra
RREZET E YLBERIT
shkrepin në fytyra.

GËZIMI I JETËS

- lexuesit

Rreze gëzimi
dëshiron?
kërko, jeta
t'i dhuron...

janë të lehta
shumë të lehta,
mu si pendla,
mu si fleta,

gudulisen,
joshen, rriten,
tok me jetën
koloviten,

kur këndon
ato i shpreh,
ardhmerinë
kur e pandeh,

edhe libra
kur të lexosh
rreze jete
do të fitosh...

KUR LIND DIELLI

Terrin e nd'rroi drita,
kaltëria muar fytyrë,
rrezet e kuqllimita
derdhen në shumë ngjyrë.

Mbi vetull të malit,
në faqe të pyllit
në këtë ditë të majit,
ja, u duk syri i yllit...

Ndrinin rreze-artat,
japin jetë, miklojnë,
f'mijës ia largojnë ëndrrat
n'prehën t'vet e ftojnë.

Ligjërojnë bilbilat,
gonxhet çelin synë,
valvit lulëllat
puhia kah frynë...

Sa bukur, sa bukur...
(si të shprehem vallë!)
qesh çupa krahëflutur,
qesh me rreze n' ballë!

MUZGU DHE GJUMI

Zhagaz dielli
tërheq rrezet,
fillon hëna
n' gaz të shkrehet;

shpeshet muzgu
në përftim,
murret qielli
për shikim;

përpin terri
çdo shamatë
dhe vjen gjumi
si për natë:

fëmijët i merr
dhe i miklon,
ëndrra t'mira
u dëfton.

12

BALERINA E NËNËS

Zemrën ma kënaqe,
të paça me shëndet,
moj krahfluturake,
shpirt i nënës s'vet!...

Ke fustan të shkurtër,
rrudha tufurrak
e leshërat e krehura
bukur për merak.

Rritmu bij' e nënës
mbushmu me gëzime,
dridhe hidhe shtatin
balerina ime!...



13

Ç'TË BËHEM?

A t' bëhem si dreri,
të pi ujë ndër kroje?
a t' bëhem si peshku
e t' lahem ndër proje?

të bëhem shqiponjë
mbretëreshë n' fluturim?
a të bëhem lule
t' shkrihem n'erëzim?

a t' shkoj t' bëhem rreze
të lundroj në gjithsi
apo t' jem përherë:
njerim¹ -lavdi?

M' thuani, pra, ju lutem,
si të veproj, vallë,
dua të jem më i zoti:
t' kem fuqi të rrallë!?

1) njerimír - njeri i mirë

14

GAZETASHITËSI

Gazeta, gazeta,
lajme të fresk'ta,
si rrezet e dritës
lajmet e ditës!...

Ja shok, ja vëlla,
blej këtu sa ka...
nga duart plot njomësi,
nga sytë plot dashuri!...

Gazeta, gazeta,
ore, jungjatjeta!...

K'shtu gazetashitësi
për çdo ditë punon,
me mund po me nder
bukën e fiton.



15

FËRFËLLAZA

Fiu, fiuu...mbi shtëpi,
fiu, fiuu... në çardak!
-Ç'po sulmon, ç'trebesh i zi?!
-Rrah fërfëllaza si dajak!

Fiu, fiuu... pa, pushim
thërmon gurë e çon furtunë,
vjen prej malit me tërbim,
fjaskon faqet me përdhunë.

Plandos zogun në ograjë,
e dridh lirin shumëvjeçar,
e struk plakun mbi postajë,
por s'e tremb Lulin shkollar,

sepse Luli ka përvojë,
nga fërfëllaza s'dron aspak,
skuqur faqesh si në lojë
shkel frymëshumen mu në bark.

16

AKSIONISTËT

Jemi vullnetarë,
jemi aksionistë¹,
jemi gjelbrimtarë
t' rrethit ekologjist²!

Do t'i ndërtojmë rrugët,
do ta mbëltojmë shpatin,
do t'i ndreqim urat
dhe ta ndihmojmë fshatin;

do ta bëjmë tërë vendin
që të lulëzojë,
do ta bëjmë gjithkëndin
jetën ta gëzojë...

Jemi shokë të mbarë,
të rinj ekologjistë,
jemi vullnetarë,
jemi aksionistë.

1) aksionist - pjesëmarrës në aksione të rinisë
2) ekologjist - mirëmbajtës të mjedisit,
gjelbrimtar.

17

SHOFERI

Ty, ty, ty ... sirena
rrugës po lajmëron;
veni re voglushë
auto po kalon.

Ecni trotoarit,
rrug've mos qëndroni
se shofer krenarin
shumë e pengoni.

Ty, ty, ty... sirena
fëmijë po lajmëron
se shoferi i vogël
tani shpejt kalon.

Është vocrrak Skënderi,
krosist-timonier¹
që e kreu shkëlqyeshëm
kursin për shofer.

1) kronist-timonier - prin në kros në gara në
vrapime terreni të llojllojshme.

18

PATINAZHISTJA

Do ta njihni
një vogëlushe:
elegante
kaçulushe,

që ushtrohet
në skijim,
rrëshqet e sillet
me nxitim,

loz mbi akull
vallëzon,
balerinës
ia kalon,

përgatitet
tash për tash
që të dalë¹
në patinazh¹;

1) patinazh - rrëshqitje artistike mbi akull.

19

kjo do të jetë
yll ndër lojtare,
më e mira
ndër valltare,

princeshakulli
do ta quajnë
ndër artiste
do t'a shquajnë!



20

PIKTORJA DHE MJEKRA

Vajza mori ngjyrë e brushë
vizatoi lulen në fushë...
Pikturoi nënën e babin
në livadh ka mblidhnin barin,
edhe motrën me gërsheta
duke ngrënë petulla t'nxë'ta,
mandej vëllanë me çantë ndër duar
edhe dajën hipë kaluar;
vetes ia vuri një kapele
me rreth t' gjerë e me kordele...



21

... Pikturoi e pikturoi
edhe gjyshin s' e harroi...

Porse ky gjysh mahitari,
për çudi vërei më i pari:

-Bijë na u bërë më e dëguara
për punimet e qëlluara,
po këso mjekre që m' kë vënë
unë s'e kam, kush ma ka shtënë?!

- Gjysh ia mora plakut të përrallës!
-tha e u skuq çupa prej marres!

22

INXHINIERJA E GJYSHES

GJYSHJA:

Oj vogëlushe, hollashkurte,
merre furkën tir shtëllunga
e t'i vëmë në veg do zhguna...

Rroki k'rrabzat thur çorapa,
qit shumë therça, lara-lara,
shih yrnekun më përpara ...
Mos krrabzo sall me një fije,
që na e paske detyrë shtëpie!

Besa tash pëllhurën ende,
se unë plakushja kam në mendje,
këmisha të gjera, shokë për brez
e shallvare të të pres.
Dhe t'i bijo qepti vet,
se tash bërë tamam vjet...

23

VOGLUSHJA:

Gjyshe, t' lutem, ik shakasë,
ato tash bota s' i qasë,
dëgjo Loke pa mahi
do ta them një fshehtësi:

Do të bëhem gjyshja Mrikë,
inxhinierë në fabrikë
ku prodhohen prej pëlhurash
rrobe f' mijsh, grash e burrash,
atëherë ne me siguri
do të kemi lumturi,
do të kemi vesh' e jetë
çka na duhet me të vërtetë!

24

DOKTORESHA E VOGËL

Do të bëhem mjeke,
mjeke e vërtetë
që t' shëroj t' sëmurët
sa më shpejt e lehtë;

kur te kem vizitorë
fëmijë që s' shajnë e s' grinden
do t' u jap bonbone,
shurup - mjaltë të ngihen;

kur ndonjë i moshuar
s' do t' mitur as lojë
do t' i shkruaj receta:
t' ketë urti, të dojë;

e për hallën Dudë
që na tut pa hak
do t' i jap gjilpëra
për ta therrë ngapak...

25

Pra kur t' bëhem mjeke
nuk do të harroj unë:
me mend e palodhje
do ta bëj çdo punë,

do të jem e sjellshme
do t' kem shumë kujdes,
gjith' me buzëqeshje
do t' ju përshëndes.

26

MOTRËS INFERMIERE

Mantelbardha mirëbërëse
vetëmohuese¹, shpresëdhënëse
mu në çaste heqje-zie
të ndihmon pa far' mërzie...

të mjekon, afër të rri,
prandaj kush t' mirën s' ia di?
Kush s' i shpreh fal' nderim
nga ajo kur gjen shpëtim!

Pra ne motrën zemërngrohtë
e nderojmë me plot dëshirë;
dhe ajo me gjak të ftohtë
na buzëqesh e shërben mirë...

¹) vetmohuese - le pushimin e vet për hir të të sëmurëve.

27

DENTISTI

Të dhemb dhëmbi
ti mos druaj,
por dentistit
shpejt ia thuaj.


E dentisti
doktormadhi
therjen dhëmbjen
do ta ndali,

se mjekmiri
dorëlehtë
mjekon dhëmbët
me të shpejtë...

...mbush, nxjerr,
ven, rregullon
dhe përherë
na këshillon:

28

t'i lajmë dhëmbët
t'i pastrojmë
vazhdimisht
mos të harrojmë.



29

MIRADI PËR MJEKUN

Më tregoni miq të shtrenjtë
a ka vepër më të shenjtë
se të sëmurin ta shërosh?

a ka punë më të madhe,
të guximshme dhe humane¹,
sesa vdekjen ta luftosh?



1) humane - ndjenjë e lartë e fisnike dashuria për njerinë.

30

dhe a ka gjë më me vlerë
më magjepse¹ dhe më nder,
sesa jetën ta shpëtosh?

Ku të gjejmë pra, fjalurime²
për doktorin shpirtfisnik,
zemërbardh, më të mirin mik?!

1) magjepse - shumë tërheqëse;
2) fjalurim - fjalë për të urrear, falenderuar.

31

BJESHKËTARËT

Lulja e bjeshkës
për ne çel,
fresku ballin
na përkdhel

ujt e kroit
na fladit
lehtë puhia
na pahit;



32

n' lisa t' gjatë
e të deg' zuar
k' ndojnë bilbilat
të gazmuar...

banjo dielli
bëjmë për sh'ndet
si zeshkanët
në bregdet;

si mikëpritës
bjeshkëtarë,
pranojmë miq,
shokë - shkollarë.

33

DETI

Kaltërosh
ujëdlirë,
kotet deti
plazhamirë;

kur puhia
ia lëmon faqet
ky i qetë
fle, kënaqet;

ëndërron
e valëzon,
bukuri
vetes i shton...

me detarët
det-babajë
thur këngë
për brigje, maja;

34

dashamirët
për verime
i pranon
me ledhatime:

u jep shëndet,
u jep gëzim,
me rrezitje,
me freskim


dhe i njeh
notarët miq
me pulëbardha,
peshq e fiq...

35

DETARI

Jam detar,
marinar,
trim i regjur -
guximtar,

këtu u linda,
këtu u rrita,
n'prehën t'valës
m'çeli drita;



36

n'erna t' lehta,
n'ujra t'qeta
kur lundroj
më rritet jeta;

e ndjej veti
si bir deti,
prandaj s'dua
t'jetoj ngjeti¹

dhe n'stuhi,
në lemeri
unë luftoj
në gjirin e ti';

trim -stoik²,
shpirt çelik
përballova
çdo rrezik.


1) ngjeti - gjetiu, në tjetër vend;
2) stoik - ai që nuk ligshohet para valëve të jetës,
vështirësive.

37

MINATORIT TË GALERISË

Xha-fortak
o minator,
me pishqole -
kompresor,

që bren shkëmb
e then granit
me trotil,
me dinamit



38

dhe kryen vepra
madhështore
shumë të vlera
njerëzore,

ne vocerrakëve
na mahnit
me thesarët
që qet n'drit'...


të nderojmë
HERO-NJERI
që derdh djersë
në galeri!

39

BUJKU - TRAKTORIST

Po zhurmon traktori
në rrafshin bukanik¹,
gazmon bujk- malsori
me shpirtin çelikuç

drejton e rri hipur,
fërshëllen, këndon,
ballqeshur, syndritur
lëndinën lëvtron;



1) vend bukanik - tokë bukëdhënëse, tokë pjellore.

40

Bën ugar çdo arë,
pregatit për t' mbjella,
lë pas radhë-radhë
hulli t' gjera, t' thella...

Si ai dhe bujkësja
qesh me plot dëshirë,
se n' ara dhe n' vreshta
patën fryt të mirë.

41

MURATORI

Me duar t' ashpra
shumë fortake,
me shikime
mprehacake,

gur' mbi gurë
e tull' mbi tullë
i ngrita sht' pinë
dhe t' voglit Dullë;



42

dalëngadale
kate-kate
unë ndërtova
dhe pallate.

Oh, sa gëzohem
mbi çatia,
kur e shoh
si lind risia¹,

e si gëzohen
nipa, mbesa
rehatueshëm
ndër banesa,

pandaj unë
gëzohem shqim
kur t' më njihet
mundi im.

*1) risia - jetë e re, e gëzueshme, që sjell lumturi
shoqërore.*

43

BUJKU - KOMBAJNER

Është korrtar i vyeshëm
dalohet ndër shokë,
punon mirë si duhet
kashën rrafsh për tokë.

Kur zhurmon makina
e thasët mbushen plot
bujk kombajneri
e ndjen veten zot...

Gëzohet sa herë korr
arëmadhen pa kufi;
tokën djerr, sinoret¹
i ka halë në sy.

Shpesh përgëzon fëmijët,
fëmijët përshëndet,
ngrohësinë familjare
e gjen n' shpi të vet.

¹) sinor - trap, kufi arash.

TË SHIRAT

Dielli djeg - vapa rëndon
teferiçi - hija fton,
ndërsa bujku po shpejton

se kalliri mustak'varë
e ka ftuar n'arë
të shkojë sa më parë;

me korrës e korrtare
do të hidhet në valle,
n'valle shumë të madhe;

të hidhet me t'vërtetë
në vallen më të shpejtë
që i sjell bukë e jetë...

Eni shihnie, vallen sot
që e hedh bujku kryezot
për grur-arin kokërrplot...

Dhe fëmij' t' pors bilbila
n'k'to të shira - bukë të re
këngë, valle më të mira
thurin, lozin plot hare.

VRESHTARËT E RINJ

Ca vogëlushë e çupulina
bisedonin një pasdreke
për vreshtmadhen në Rrezina
aty afër Suhareke,

ku si bjeshkë a park i rrallë¹
duket vreshta pambarim
mbushur pjergulla radhë - radhë,
kënaqet syri me shkim.

E n' hardhia kalavesh
duket rrushi bukuri,
kokërrbardh e kokërrrez
si rruzare për hijeshi;

rrush i kuq, kokërr qershí,
rrush ermues, kokrrak ngjyrari,
thanc të bardhë e thanc të zi²
mund të gjesh mjaft kësajtpari...³

N' fund këta të rinj vreshtarë,
si nxënës të mirë e punëtorë,
u zotuan që sa më parë:
të bëjnë vresht n' kopshtin shkollor.

¹) i rrallë nga bukuria

²) lloje rrushi

³) kësajtpari - kësajpanti

BOSTANXHIU

Tuk, tuk, tuk...
mbi shalqin klokas
a duhet ta nduk!?
më mirë ta shoh pas:

paska dukë sikungull,
lozët shumë mbërdhezë,
larëzat ngjyrëkumbull,
lulen tharë - pikëzezë.

Tuk, tuk... krap,
shalqinin e peshoj,
por a e kam qëlluar
ende s' e besoj?...

Kër, kër ... vazhdo preje,
kuq, kuq ... shih rrezim,
farzat ngjyrë kafeje,
zemrën plot mjalitim;

sa i brishtë, ujë shërbet,
po shkrihet në gojë
me punë, me vullnet
gjithkush do ta gëzojë.

¹) klokas - rrah me klokë, me gisht (thua) të dorës
për ta provuar a është pjekur shoqin!

BABI MEKANIK

Babi im është komandar
për ushtri të tërë makinash
në punë të veten është krenar
ne na sjell gjithfarë të mirash.

Mekanik është në elektranë
ku punon me shumë vullnet,
shpërndan rrymën n'katër anë,
urdhëri i tij është pushtet.



48

Bën me dritë dhe ato fshatra
që koha gati i pat harruar,
atje sheh si meh mandata
dhe për sy gati t'verbuar...

Dhe pse dehet në çdo fitore
thjeshtësinë ai mund ta ruajë¹:
shpreh përherë reze gazmore...
s' do askush të heqë, të vuajë.

¹) Është gjithnjë modest, nuk e rrit mendjen.

49

ROBOTI FANTASTIK¹

Pa dëgjoni o fëmijë t'urtë
për një shpikje shumë të rrallë:
për robotin që sigurt
punon mu si njeri i gjallë?!...

Ai me trurin elektronik,
mëjton, flet e kupton mirë,
kryen punët si shkop magjik,
pa mëzmi me plot dëshirë;

Edhe fëmijëve kur t'ua kënda
u ndihmon si për të jetuar,
i këshillon me fjalë të ëmbla
që gjithmonë të jenë të gëzuar!

¹) fantastik - i jashtëzakonshëm, pjellë jo e vëretë e mendjes

50

KROI I ÇUDITSHËM

Ca malorë - natyralistë,
që gjezdisin si turistë,
kështu u folën pas shtetie
shokëve të vet - shokë fëminie:

Mrekulli shumë e shumë
pamë ndër male kah njaj lumë,
por si dolëm për mbi fshat
dhe soditëm shpat më fshat
pamë një krua n'rrëzë të pyllit
ku po lahej rrezja e diellit,
kah shëndriste si pasqyrë
uji i pastër, uji i mirë...

Por ai krua si për çudi,
s'po pranuaa çdo njeri,
fëmija i ndytë, thonë, si t'afrohet
uji i kroit turbullohet !...

Prandaj ne t'gjith pastër rrimë,
malit - fush's fshehsinë ia dimë
dhe shijojmë çdo bukuri
që natyra e ruan në gji!

51

QENGJI

Qengjit të vogël
bardheçak
këmbët e holla
s'i bëjnë lak,

sytë e bukur
larg i shohin
edhe nënën
shpejt e njohin,

gëzofi i rritet
plot shkëlqim,
rend, lodron
hiç pa përtim;

nënëveten ¹
e do shumë,
kurr s'e lodh
s'e le pa gjumë,

1) nënëveten - nënën e vet (në gjuhën e fëmijëve)

s'i bën naze
s' e idhnon
për këtë punë
ajo e don...


Dhe jot'ëmë
si për miklim
shpesh t' thotë:
-Eja, qengji im!

QENI I DRESUAR

Qeni i Cenit
laraman
ec mbi vig
si pehlivan

rend, kërcen,
s'lodhet aspak;
noton lumit
si rosak;

shetit pyllit
si trimosh
bishtadredhur
katarosh;



1) qeni i dresuar - qeni i ushtruar; i mësuar

dhe n'kullosa
me barinë
ruan stanin
bagëtinë

dhe herë-herë ec,
hulumton,
grigjen, vendin
kontrollon.

DORDOLECI PREJ BORE

Disa shokë, disa trima
bënë një Dole te lëndina;
trashalluk, barkun si kosh,
kryetullac e musteqosh,
ia ngjynë gojën, sytë me vetull
e ia vunë një shkop nën sjetull;
hunda shyt pakëz i mbet,
por e bën si deshtën vet.



56

Tash ky Dole - dordo|ec
endej natën si kasnec¹!
u përftohej² fëmijëve n' gjumë
fort krenar, gëzuar shumë.

E një natë nëpër dritare
era u solli kësofarë fjale:

"Kryet e Doles iku n're,
barku iu zbraz, i shkoj me she³,
i kanë mbetur te lëndina,
veç mustaqet e shtag - martina!"

- 1) kasnec - tellall, lajmtar
2) përftohej (u) - u bëhej
3) she, - prroskë

57

QORTIM PRINDOR

Vallë, ç'të duhet shtat gjithaq
dhe ato faqe si kulaç,
kur nuk sillesh si ka hije,
si punëmbarë, gëzimshtëpie,

pse ti vonë rëndomë po zgjohesh,
s'lanë syefaçe e shfajsohesh?!
me brisk pret e bën shumë dhendla¹
për thonj fare nuk t'shkon mendja!

i mbush xhepat, gjëra plot
faculetë s' të gjindet dot!
Ca punë shtëpie i kryen me qykë²,
punon fitohshëm, fshamjen n' grykë!

Dhe pas topit, ndasht pse rend,
po pse bën gjestez pa vend:
pse gëlthet, pse shan, pse qirresh,
pse s'i duhet nuk po sillesh?!


- 1) dhendla - bujashka të vogla
2) me qykë - i kryen me kokëfortësim me zori
3) bën gjeste - shynë me duar, etj.

58

Shokët po të quajnë nervoz,
po të thonë naks e tekanjosh
dhe ty fare s'ta ka ënda,
kur dëgjon këso fjalësh të rënda,

prandaj veset duhet të flaken,
s'duhet lënë me ty të mplaken...
Çdo i ri dëgjon këshilla
dhe stoliset me të mira,

pra dhe ti prano urti,
që gjithkush me të marrë lakmi!



59

IMITUESI MAHITAR

Është i vogël
picërruk¹,
leh si qen,
ul'ron si ujë,

kllok si pulë,
këndon si gjel,
cin² si zog,
si harabel;

di si qyqe,
si hutin,
mu si macja
mjauillin;

blegëron
si qengj, si dash:
e bën zërin
holl e trash;

1) picërruk - picërr, i vogël
2) cin - ciat, cicëron

melodi dhe këngë
gazmore,
shfaq në mbrëmjet
muzikore,

por as mësimet
s'i harron
e do klasa
mësuesi e don.

GRISHJE PILOTI

Faqja e qiellit
kaltëroshe,
që shkëlqen
qoshe m'qoshe,

përkund ëmbël
diellin sy
edhe hënën
me gjithë yj,

grish vogëlushin
me shikim
n'prehën të vet
me i dhënë pushim.

Ti vogëlush,
pilot i mirë
ngjitu lart
n'se ke dëshirë!

STJUARDESA

Sot n' mëngjes
vogëlushja Besë
i tha s'ëmës
se do të bëhej
stjuardesë,

të shetisë
nëpër qytete
mbi katunde,
fusha, male
e mbi dete,

bashkudhëtarët
t'i shoqërojë,
ëmbëlsira
e buzëqeshje
t'u dhurojë,

xha-pilotin
sysokol
ta gostis
me arangjata
e mentoll,

ta mbajë mirë
uniformën
e nga larg
të përshëndesë,
ta luajë dorën.

ASTRONAUTI

Jam i vogël, por jam trim
se nuk druaj aspak
e kam zemrën Gagarin
botës i bij qark.

Sythi i mendjes - behar
shkon e shkrep n'çdo skutë,
jam i lumtur, jam krenar
për këtë marshrutë¹.

Vështroj këndet e gjithësisë
me pëllumb t'paqes në gji,
shpërndaj rrezet e njërëzisë,
hap për t'lumen ardhmeri...

¹) marshrutë - rrugëtimi që duhet kaluar,
drejtimin marshimit ose i udhëimit

FËMIJËT DHE DIELLI

Shjerë, o diell, shjerë,
rrezet për ne shjerë,
për lule, për erë
që të kemi pranverë
në tonin atdhe.

Shjerë dritë, ngrohësi,
shjerë jetë, risi,
shjerë fat më shumë
dhe për peshq në lumë...
për njëzëzit shërbe!

Shjerë, ngjall dëshirë
për një jetë më të mirë
se ne më tzo do të jemi
dhe ty n'dorë do t' kemi,
dëgjiona pra ne!...

ZËRI I TRENIT TË VJETËR

Zemrën hekur, rrugën hekur,
gvuf, gvuf, gvuf...
Jam hardall, në punë i regjior,
gvuf, gvuf, gvuf...

Punoj natën, punoj ditën
sa jam gjallë,
duf-dufas, lart e ngre tymin
me vërdallë!

Kënga ime është e vjetër,
me të vërtetë,
motra ime ka këngë tjetër
më të lehtë,

pra dëgjom¹, voglush të lutem,
sa s'u mpaka
ripërrimë, ndërroma zemrën
se u mplaka...

t'shkoj mbi fusha e mbi male
me këngë të re,
t'i shohë gëzimet e kësaj jete
plot hare!

¹) sa s'u mpaka - sa s'më ra të fikët

PËRBAJTJA

Sqarim,	7
Rrezet e yllberia,	9
Gëzimi i jetës,	10
Kur lind dielli,	11
Muzgu dhe gjuni,	12
Balerina e nënës,	13
C'i të bëhem?,	14
Gazetashitësi,	15
Ferfillaça,	16
Akionistët,	17
Shoferi,	18
Patnashistja,	19
Piktorja dhe mjekrra,	21
Inzhinierja e gjyshes,	23
Doktoresha e vogël,	25
Motrës infermiere,	27
Dentisti,	28
Miradi për mjekun,	30
Bjeshkëtarët,	32
Deti,	34
Detari,	36
Minatorit të galerisë,	38
Bajku - traktorist,	40
Muratori,	42
Bajku - kombajner,	44
Të shirar,	45
Vrështarët e rinj,	46
Bostanxhiu,	47
Babi mekanik,	48
Roboti fantastik,	50
Kroi i çuditshëm,	51
Qengji,	52
Qeni i dresuar,	54
Doridoleci prej bore,	56
Qortim prindor,	58
Imituesi mahitar,	60
Grihshje piloti,	62
Sjnarësja,	63
Astronauti,	64
Fëmijët dhe dielli,	65
Zëri i trenit të vjetër,	66

NUHI VESELAJ
RREZET E YLBERTA

Mbulesën e ilustrimet
KUJTIM SHALA

Redaktor teknik
SKENDER HOXHA

Korektor
FEHMI SPAHIU

Realizimi kompjuterik
ARS poetica
Prishtinë